



RELACION TEKNIK

**HARTIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT REHABILITIM URBAN NE
TE DY ANET E RRUGES “ARKITEKT KASEMI”, BASHKIA
SKRAPAR**

PËRGATITI: “HTS COMPANY” SH.P.K

PERMBAJTJA

1. HYRJE
2. TE PERGJITHSHME
3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT, GJENDJA EKZISTUESE
4. FOTO NGA GJENDJA EKZISTUESE E TROTUARIT KU DO TË KRYHEN PUNIMET
5. NDËRHYRJA
6. SINJALISTIKA RRUGORE
7. ORGANIZIMI I PUNIMEVE

1. HYRJE

Hartimi i projekt zbatimit per objektin **“Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës “ARKITEKT KASËMI”**, Bashkia Skrapar do te realizohet me fonde nga buxheti i shtetit.

Ky projekt do te ndihmoje ne gjithëpërfshirjen e zonave të ndryshme në strategjitë e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor, pasi sektori i infrastruktures ofron mundësi permiresimi te imazhit te pergjithshem te qytetit dhe sistemimit te tij.

Gjithashtu nepermejt permiresimit te infrastruktures arrihet nje prezantim me i mire dhe me i lehte i aseteve kulturore, kulturës dhe kulinarisë.

2. TË PËRGJITHSHME

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi siguron respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit.

Vendndodhja: Rruga “Arkitekt Kasëmi”

Qëllimi i projektit të propozuar: Qëllimi kryesor i projektit është të permiresojë mjedisin urban, të krijojë hapësira miqësore për funksionimin e kësaj zone si infrastrukturë e mirëfilltë bashkëkohore dhe kthimin e saj në shërbim të komunitetit.

Ndërhyrja konsiston në rehabilitimin e trotuarive ne te dy anet e rruges “Arkitekt Kasemi”. Ky investim synon të bëjë të mundur sigurinë e lëvizjes së këmbësorëve. Projekti synon përshtatjen e saj me rrjetin rrugor kryesor të qytetit. Përfituesit direkt të projektit janë banorët dhe frekuentuesit e zonës.



Fig 1. Segmenti i rehabilitimit te rruges “Arkitekt Kasëmi”



Fig 2. Segmenti nga qendra e qytetit deri te ura e vilave



Fig 3. Segmenti nga ura e vilave deri te kryqezimi me rrugen "Hetem Kapinova"

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT, GJENDJA EKZISTUESE

Në detyren e dhënë për hartimin e projektit të zbatimit për "Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës "Arkitekt Kasëmi", jepen përshkrimet, detajet për projektin e zbatimit si me poshtë:

Rruga "Arkitekt Kasëmi" është rrugë urbane kryesore e qytetit të Çorovodës. Ajo fillon nga qendra e qytetit dhe shtrihet në pjesën e ulët të qytetit, përgjatë bregut të djathtë të lumit të Çorovodës, deri në kufirin veriperëndimor të qytetit.

Ne baze te detyres se projektimit ne kete projek do te trajtohet rehabilitim i trotuareve dhe shesheve në të dy krahët e rrugës “Arkitekt Kasëmi”, për segmentin, nga qendra e qytetit deri te ura mbi lumin e Çorovodës, ku kryqëzohet rruga “Arkitekt Kasëmi”, me rrugën “Hetem Kapinova”, si dhe rikonstrukcionin e urës së Vilave.

- **Segmenti i rrugës nga qendra e qytetit deri te ura e Vilave.**

Ky segment ka një gjatësi rreth 450m, me ndërtesa në të dy krahët e rrugës. Në krahun e majtë ekzistojnë kryesisht ndërtesa banimi 5 katëshe me katet përdhe njësi shërbimi, por edhe ndërtesa më të ulëta 1-2 kate me funksion industrial apo shërbimi.

Në këtë krah trotuaret nuk ekzistojnë fare.

Gjithashtu ambjentet para ndërtesave në kufi me rrugën, janë të pa trajtuara.

Ndriçimi mungon pothuajse totalisht. Gjelbërimi mungon totalisht.

Në krahun e djathtë të këtij segmenti nuk ka ndërtesa banimi. Ndërtesat janë 1-2 kate me funksion shërbimi.

Pavarësisht se në këtë krah ekzistojnë kufizimet e rrugës me bordura betoni, trotuaret janë të çrregullt të ndërtuar vetë nga pronarët e bizneseve, shpesh herë vetëm me beton, ndërsa në një distancë të konsiderueshme trotuaret mungojnë fare.

Ndriçimi gjithashtu mungon totalisht ashtu si dhe gjelbërimi.

- **Segmenti i rrugës nga ura e Vilave deri te kryqëzimi me rrugën Hetem Kapinova**

Ky segment ka një gjatësi rreth 390m, me ndërtesa vetëm në krahun e majtë të rrugës. Në krahun e majtë ekzistojnë kryesisht ndërtesa banimi private 1-3 kate si dhe një pallat 5 katësh. Pavarësisht se në këtë krah ekzistojnë kufizimet e rrugës me bordura betoni, trotuaret mungojnë plotësisht.

Gjithashtu ambjentet para ndërtesave në kufi me rrugën, janë të pa trajtuara. Ndriçimi mungon totalisht.

Gjelbërimi mungon totalisht

Në krahun e djathtë të këtij segmenti, i cili ka trotuarin dhe kufizohet me lumin e Çorovodës, bashkia ka realizuar ndërtimin e trotuarit, murin kufizues me lumin si dhe mbjelljen e pemëve. Janë shtrirë brenda trotuarit shllagat e rrjetit të energjisë si dhe janë realizuar gropat e shtyllave. Mungon rrjeti i ndriçimit si dhe shtyllat.

- **Ura e Vilave**

Ndërmjet dy segmenteve të përshkruar më sipër, ndodhet ura e Vilave. Ura është ndërtuar para shumë viteve me konstrukcion metalik. Dikur përdorej vetëm për hyrje-daljet e automjeteve

qeveritare, ndërsa sot përdoret nga të gjithë banorët. Ura lidh rrugën “Arkitekt Kasëmi” me rrugën “Tefik Rogu”.

Gjendja e urës paraqitet e tillë: mbishtresa e urës përfshirë pllakat e betonit është krejtësisht e dëmtuar.

Parmakët anësorë të urës mungojnë.

Ndriçimi gjithashtu mungon.

4. FOTO NGA GJENDJA EKZISTUESE E TROTUARIT KU DO TË KRYHEN PUNIMET



Fig 4. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 5. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit




Fig 6. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 7. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 8. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 9. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 10. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 11. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 12. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit



Fig 13. Foto te gjendjes ekzistuese te trotuarit

5. PROJEKT-ZBATIMI, NDËRHJRJA

Bazuar ne detyren e projektimit te hartuar nga Investitori nga ana jone si shoqeri projektuese, eshte pergatitur materiali i nevojshem teknik per hartimin e projekt-zbatimit.

Ne kete projekt-zbatimi jane parashikuar nderhyrjet si me poshte:

1. Sistemimi i trotuarëve në të dy anët e rrugës “Arkitekt Kasëmi” për segmentin që është përshkruar ne detyren e projektimit.
2. Bordurat dhe kundrabordurat e trotuarëve do të jenë betoni të parapregatitura, në mënyrë që të shfrytëzohen bordurat ekzistuese që janë ne gjendje te mire.
3. Trotualet jane parashikuar me tulla rate me kombinime me gjyra. Ngjyrat dhe forma e tullave jane perzgjedhur në bashkëpunim me Bashkinë Skrapar. Ne kete projekt ka bere përjashtim trotuari në krah të ndërtesës së Bashkisë, i cili për tu harmonizuar me punimet e pedonales në qendër të qytetit eshte projektuar per t’u ndërtuar me pllaka guri (7-10x25x40) cm. Ngjyra e gurit eshte dakortësuar me Bashkinë.
4. Gjerësia e trotuarit do të jetë 2 m, me përjashtim të segmenteve që kanë gjerësi më të vogël nga fasadat e ndërtesave të bizneseve, gjerësi e cila eshte projektuar me e vogel se 2 ml.
5. Eshte bere sistemimi i ambienteve që kufizojnë trotuarin me fasadat e ndërtesave. Per kete rast jane parashikuar sipërfaqe të gjelbëruara, apo element urbane.
6. Per trotualet qe nderpriten me rrugen apo me ambientet e godinave te ndryshme jane projektuar panduse.

7. Jane rakorduar hyrje-daljet për automjetet që lidhen me blloqet e banimit apo bizneset, të shoqëruar me sinjalistikën përkatëse;
8. Në pjesët me disnivel midis trotuarit dhe bizneseve, është realizuar kullimi i ujrave ku pjerrësia e trotuarit të jetë nga ana e rrugës ku është rrjeti inxhinierik;
9. Në pikën ku kryqëzohet rruga “Arkitekt Kasëmi” me rrugën “Hetem Kapinova”, për sistemimin e trafikut, në projekt është parashikuar ndërtimi i një rrethrotullimi apo zgjidhje të tjera që do të propozohen nga projektuesi;
10. Përgjatë gjithë segmentit rrugor, është parashikuar sinjalistikë horizontale dhe vertikale atje ku është konsideruar e nevojshme, si për automjetet ashtu dhe për këmbësorët;
11. Aty ku ka qene e mundur, në projekt është parashikuar mbjellja e pemëve.
12. Përgjatë trotuarit në kufi me rrugën, në krahun e djathtë të rrugës, nga Ura e Vilave deri te kryqëzimi i rrugës “Arkitekt Kasëmi” me rrugën “Hetem Kapinova” është parashikuar vendosja e kangjellave metalike
13. Gjithashtu është parashikuar ndriçimi me llampa LED;
14. Pusetat elektrike do të jenë plastike, ndërsa shtyllat do të jenë metalike, me konfiguracion mesatar, me dy koka me lartësi: shtyllë 4.5m në rastin kur përdoren vetëm për ndriçimin e trotuarit dhe shtyllë 8.8m në rastin kur përdoren dhe për ndriçimin e rrugës, me krahun nga rruga në kuotën e sipërme dhe krahun nga trotuari në të njëjtën lartësi, si shtyllat e trotuarit.
15. Për urën e Vilave është parashikuar të realizohet rikonstruksioni i urës me konstruksion metalik, konkretisht mbistruktura, parrmakët anësorë, ndriçimi si dhe trajtimi i rrugës në hyrje dhe në dalje të urës;

Sipas dokumentacionit teknik, projekt - preventivit dhe specifikimeve përkatëse, punimet që do kryhen për këtë objekt janë:

1. Punime prishje ku përfshihen punimet për prishjen e trotuarit, dhe transportimin e tyre për në vendin e përcaktuar nga Bashkia për hedhjen e mbeturinave.
2. Ndërtimi i trotuarit me shtresat përkatëse.
3. Ndërtimi i pandueseve
4. Mbjellja e pemëve pas përgatitjes së tokës.
5. Ndricimi pergjate rruges dhe pergjate trotuarit ne te dy krahet
6. Mobilim urban
7. F.V vendosja e kangjellave pergjate trotuarit
8. Rikonstruksioni i urës (mbistruktura)
9. Punime sinjalistike
10. Punime per ndertimin e rrethrotullimit në pikën ku kryqëzohet rruga “Arkitekt Kasëmi” me rrugën “Hetem Kapinova”

5.1 Metodologjia e punës e ndjekur gjate hartimit te projektit

Ne baze te detyres se projektimit për “Hartimi i projektit te zbatimit Rehabilitim urban ne te dy anet e rruges “Arkitekt Kasëmi”, Bashkia Skrapar u përcaktuan objektivat dhe u realizua program i punes i meposhtem:

- Vizita në objekt, identifikimi, analizimi dhe vleresimi i situates ekzistuese
- Fotografimi i zones ku do te nderhyet

- Rilevimi topografik i zones
- Mbledhja e te gjithë informacionit dhe paraqitja e varianit per projekt-ide
- Pas miratimit, paraqitja e projekt-zbatimit me te gjithë elementet referuar detyres se projektimit.

5.2 Koncepti i ndërhyrjes

Për zhvillimin e konceptit te nderhyrjes eshtë konsideruar parimi për hartimin e zonave te këmbësorëve.

Trotuaret jane projektuar dhe duhet te ndërtohet qe të jenë te sigurt. Gjithashtu eshte ruajtur karakteri ekzistues i zones duke shfrytëzuar ne maksimum funksionet (psh, jane konsideruar elementë të mobilimit urban) dhe duke përmirësuar ato ekzistuese.

Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasysh zgjidhja ne anen planimetrike te trotuarit, zgjidhja ne anen altimetrike dhe elementet sociale.

1. Zgjidhja planimetrike

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasysh ndertimi i trotuarit te behet ne te dy anet e aksit te rruges, me gjeresi 2ml.

Ne hyrjet e banesave, ambienteve te sherbimeve apo intersektimet me rruget ekzistuese do te behet rakordimi i tille qe lejon hyrjen normale te mjeteve.

2. Zgjidhja Altimetrike

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te lehte ne renie. drejt lindje - perendimit. Eshte synuar ne krijimin e pjerresise se lehte e uniforme.

3. Profili Gjatesor

Pjese e projekt-zbatimit eshte edhe profili gjatesor, i cili perfaqeson prerjen e trotuarit sipas aksit te tij ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Vijes se Projektit
- Numri i Piketes (Seksionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distancat Pjesore
- Distancat Progressive

4. Profilat Terthore

Trotuaret dhe gjerësitë e propozuar në këto projekt janë të tipeve dhe dimensioneve të ndryshme.

Në projekt është paraqitur plani dhe prerjet terthore për secilin variant të propozuar.

Profilat terthore përfaqësojnë prerje terthor të trotuarit.

Profilat terthore janë hartuar në shkallë vertikale dhe horizontale 1:100.

Në profilat terthore janë paraqitur:

- Numri i profilit
- Distanca progresive
- Vija e terrenit
- Vija e projektit
- Disnivelet e vijës së projektit
- Numri i piketes
- Kuotat e terrenit
- Kuotat e projektit
- Distanca pjesore nga aksi
- Distanca të përgjithshme nga aksi

Në profilat tip, pjesë e projekt-zbatimit janë paraqitur në mënyrë të detajuar:

- Shtresat e trotuarit
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre
- Distanca
- Zona ku aplikohet profili tip

6. Zgjidhja sociale

Është pasur parasysh që trotuari të bëhet me parametra që t'i përshkruajnë zhvillimet e zonës dhe hyrje daljet nga shtepitë të kënaqësive.

5.3 Propozim për shtrim të trotuareve

Detyra kryesore është një shtresë e qëndrueshme dhe rezistente ndaj konsumit në një kohë të shkurtër.

Pllake trotuari



Fig 14. Foto të pllakes së betonit, forme tulle



Fig 15. Foto te pllakes se betonit, forme tulle

Pllake betoni, forme tulle, ngjyre gri ose ngjyre tulle, trashesia 6cm, permasa 20x10cm, 12m²/palet, 50cop/m²

Përshkrim i detajuar

Pllakat e trotuarit të presuara gjatë prodhimit, perbehen nga përzierja rërë-çimento e cila i është nënshtruar vazhdimisht goditjeve konstante me çekiç të specializuar. Krejt procesi i ngurtësimit së betonit ndodh nën presionin e lartë brenda formës. Pllaka e gatshme është në fakt një gurë artificial me fakturen edhe pamjen e saj të veçantë. Siperfaqe jo e lustruar, me pore, cka e ben përfekte për fushat me lëvizje aktive si te njerëzve edhe te transportit. Pllaka e presuar karakterizohet me rezistencete larte jo vetëm ndaj ndikimeve fizike. Struktura e saj poroze i lejon pllakës të “marrë frymë”, karakteristike e cila rrit numrin e cikleve të ndryshimeve të temperaturës. Raporti i ulët i ujit-çimentos tregon një imunitet ndaj sulmit kimik të mjedisit. Pllakat e betonit jane një zgjidhje përfekte për ambiente me lëvizje te ngarkuar

Specifikime teknike

- Masa: 20x10cm
- Trashësia: 6cm
- Forma: Drejtekendore

Nderhyrjet ne uren e Vilave

Punimet ne mbistrukture

Punime per parmakët anësorë

Punime ndriçimi

Trajtimi i rrugës në hyrje dhe në dalje të urës;

Trajtimi i konstruksionit metalik te ures

Do pastrohen me bombardim me rere

Do lyhen me boje antiruxh

Do lyhen me dy duar boje vaji (presence lageshtie)

Kavo te reja

Metodologjia e Ndërtimit.

Në këtë paragraf po paraqesim përshkrimin e metodologjisë së punimeve të ndërtimit të këtij objekti, ku përfshihet pozicioni i ngritjes së kantierit të ndërtimit dhe elementëve përbërës të tij. Brenda zonës së rrethimit duhet të jenë të organizuar zyrat e kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve, parkimet, vendet e depozitimeve të materialeve, fjetoret, mensa, ambientet e tjera ndihmëse, gjeneratori, etj.

Radha e kryerjes së punimeve:

1. Punimet e nënstrukturës për përforcimin e ballit.

Fillohet me punimet e nën strukturës, përforcimi i ballnave dhe riparime të tjera të strukturës. Për kryerjen e këtyre punimeve, të cilat duhet të realizohen në kohën e prurjeve minimale, kontraktori më parë do të realizojë rrugën ndihmëse për futjen e makinerive dhe materialeve.


Përpara se të bëhet përforcimi i ballnave të bëhet pastrimi i ballit ekzistues nga papastëritë. Në vazhdimësi, të ndërtohet muri beton arme për përforcimin e ballit, me qëllim që të krijohet një mbështetje më e mirë.

Në ballin masiv, të hapen vrima për vendosjen e ankerave që do të lidhin ballin me betonin e përforcimit. Hapja e vrimave, vendosja e ankerave do të bëhet në formë shahu dhe ndërtimi i përforcimit, të realizohen sipas detajeve dhe përmasave të dhëna në projekt. Gjatë zbatimit, të tregohet kujdes i veçantë në ndërtimin kallepërisë, fiksimin e elementëve dhe vendosjen e armaturës, që të mos kemi shmangie gjatë hedhjes së betonit në vepër. Të pastrohet dhe masivi shkëmbor, dhe hapësira boshe ndërmjet këtij masivi dhe faqes anësore të majtë të ballit. Pastrimi konsiston në heqjen e bimësisë dhe mbeturinave të ndryshme. Të formatohet masivi shkëmbor sipas detajit të dhënë në projekt për realizimin e shuarsit që do të shërbejë për largimin e ujrave atmosferike. Pjerrësia gjatësore dhe seksioni tërthor i kanalit të ri do të jenë të njëjta me ato të kanalit ekzistues.

Të ndërtohet muri mbajtës b/a, me lartësi H=3.0 m në vazhdimësi të murit ekzistues prej betoni, pas speronit të ballit. Muri i ri mbajtës të realizohet në pozicion dhe me përmasa sipas vizatimeve. Karakteristikat e materialeve të përdorura specifikohen në shënimet e përgjithshme. Gjatë realizimit të punimeve për ndërtimin e murit mbajtës, të bëhet kujdes që të mos dëmtohet muri ekzistues, speroni ose struktura ekzistuese e ballit. Në rast të kundërt, çdo dëmtim i ndodhura do të riparohet nga Sipërmarrësi i punimeve pa kosto shtesë, nën praninë e Mbikqyrësit të punimeve. Kujdes të veçantë të tregohet gjatë ndërtimit të kallepërisë dhe vendosjes së armaturës, me qëllim që të mos kemi shmangie gjatë hedhjes së betonit në vepër. Hapsira ndërmjet muri b/a dhe speronit të ballit, të mbushet me material të gërmuar më parëm, ndërsa pas murit, të realizohet mbushja me zhavor, të ngjeshur me shtresa sipas specifikimeve. Për largimin e ujrave sipërfaqësore, do të përdoren tuba kullimi sipas detajit “hollësi H-1”, të dhënë në projekt. Për vendosjen e tubave të kullimit, të shpohen vrima në themelin pej betoni të murit ekzistues.

Ndërtimi i shtresave të reja

Nga inspektimi i urës vërehet mungesa e planit të kullimit si dhe dëmtimi i shtresave ekzistuese. Për këtë qëllim do të ndërtohen shtresat e reja. Keto punime, së pari, konsistojnë në prishjen e shtresave ekzistuese. Këto shtresa do të hiqen duke përdorur makineri të lehta, si frezë ose mini-ekskavator me goma. Prishja e shtresës do të realizohet me matrapik dore. Gjatë kësaj faze, punimet duhet të kryhen me kujdes të veçantë për të shmangur dëmtimet e mundshme të tyre. Pas prishjes së shtresave ekzistuese, punimet do të vazhdojnë me ndërtimin e shtresave të reja sipas detajit të



dhënë në vizatim. Konkretisht duke qene se trafiku qe do te kaloje do te jete I kufizuar (Vetem vetura) pasi gjerësia eshte 225 cm do te perdoret Llamarine tip Bakllava me spesor 8 mm me peshe 129.6 kg/m² me permasa 2500 x 1250 mm e cila do te kapet me vida ne profilin e konstruksionit mbajtes te ures Persa I perket parapetit te ures do te realizohet me profila metalik cdo 1.5 m me permasa 80 x 40 mm me spesor 4 mm me peshe 7.3 kg/ml me H= 1.2 ml

Per sa I perket sigurise keto profile do te kapen me dy elemente horizontal ne krye dhe ne mes. Nga ana e brendeshme do te vishet me rrjete teli Tela Elektro galvanizuar, Teli i veshur me PVC ngjyra e zeze me trashesi 4.4 mm




Fig 16. Foto te telit te veshur me PVC ngjyra e zeze

Ndërhyrjet në strukturën e çelikut.

Përpara fillimit të punimeve të bëhet kontrolli i imtësishëm për gjendjen e elementëve të çelikut nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i punimeve. Këto ndërhyrje konsistojnë në disa proçese punimesh:

Ndërhyrje në elementët mbështetës, çernierat. Këto punime do të kryhen përpara ndërtimit të fugave të reja. Pasi të hiqen fugat e kuzistuese, do të kontrollohet dhe do të verifikohet gjendja e pajisjeve të mbështetjeve (çernierave), në prani të Supervizorit të punimeve. Pas kontroleve, të pastrohen çernierat nga papastërtitë dhe materialet mbushëse, të pastrohen me furçë teli kombinuar me rërë me presion nga ndryshku dhe të lyhen me bojë antiruxho. Balli, do të çukitet në kokë dhe më pas do të mbilartësohet deri në kuotën e poshtme të fugës, dhe do të shërbejë edhe për ankorimin e bulonave të fugës, edhe për mbrojtjen e çernierës nga mbushja me materiale. Në fund, të realizohet vendosja e fugave të reja sipas vizatimeve dhe shënimeve në paragrafin përkatës.

Riparimi i elementëve të dëmtuar të strukturës së çelikut

Elementët e dëmtuar të strukturës së çelikut janë hasur në lidhjen tërthore të kapriatave. Elementët e dëmtuar janë profile dopjo T-i, zëvendësimi i të cilëve do të bëhet me profila të njëjtë sipas vendit nqs ka elemente te tilla per tu zevendesuar

Pastrimi i elementëve strukturor të kapriatave dhe të dyshemesë.

Elementët strukturor të kapriatave dhe të dyshemesë do të pastrohen me furçë metalike dhe me rërë të veçantë (kuarc) me presion. Më pas do të bëhet lyerja e tyre me bojë kundra ndryshkut dhe me bojë dekorative.

Vendosja e parrmakëve duke e shoqëruar me elementët e sigurisë.

Kjo ndërhyrje konsiston në rrethimin aneve të ures me rrjetë teli. Rrethimi nga ana e lumit do të realizohet krejtësisht i ri, sipas detajeve dhe shënimeve të dhëna në projekt.

5.4 Paraqitje e shtresave të trotuarit




Fig 17. Detaj i shtresave të trotuarit

DETAJI SHTRESAVE TË TROTUARIT KU DO TË KALOJNË AUTOMJETE




Fig 18. Detaj i shtresave të trotuarit, ku do të kalojnë automjete

6 SINJALISTIKA RRUGORE

6.1 Hyrje

Per plotesimin e ketij segmenti me elemnte te sinjalistikes jemi mbeshtetur tek kërkesat e Kodit rrugor të republikës së Shqipërisë si dhe të “Rregullores së zbatimit të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar” (Vkm Nr.153, datë 7.4.2000 dhe nr. 277, datë 10. 03. 2010)

Sinjalistika përfshin sinjalistikën vertikale/tabelat, sinjalistikën horizontale dhe pajisje të tjera në shërbim të sinjalistikës.

Rruga eshte pajisur me te gjithë vijejimin e duhur horizontal, ky vijezim eshte parashikuar te jete bikomponent.

Vijejimi anesor eshte me gjeresi 12cm. Vija e ndarjes se drejtimeve eshte me gjeresi 12cm.

Ne kryqezimet kryesore eshte parashikuar vendosja e vijejimit perkates per kalimin e kembesoreve, me shirita me gjatesi 4m dhe gjeresi 0.5m.

6.2 Tabela rreziku të cilat janë përdorur në projekt

Vendkalim këmbësorësh

Kjo tabele paralajmëron një vendkalim këmbësorësh, pra kufizim të shpejtësisë e përcaktuar në nenin 142/1 të Kodit Rrugor.



Fig 19. Tabele rrugore

Vendkalim fëmijësh

Kjo tabele paralajmëron vend ku kalojnë fëmijë, të shkollave, kopshteve, te parqeve etj.



Fig 20. Tabele rrugore

Ne te gjitha degezimet eshte parashikuar qe tabela “STOP” te shoqerohet me nje vijezim me gjeresi 03.-0.5m.

Të gjitha tabelat do vendosen në trotuare, ngjitur me bordure kufizuese te tij.

Persa i perket sinjalistikes vertikale ne projekt eshte parashikuar vendosja e tabelave vertikale rrethore 60cm (cl 2) te cilat tregojne drejtimin e qarkullimit te automjeteve.

Ne te gjitha degezimet jane vendosur tabela “STOP” me permasa (A=90, B=30,D=75).

6.3 Sinjalet e përkohshme

Keto sinjale te perkohshme do te perdoren gjate kohes se kryerjes se punimeve ne rruge nga ana e sipermarresit per arsye sigurie teknike si dhe per te orientuar trafikun.

Gjate kohes se kryerjes se punimeve sinjalet e përhershme duhet te hiqen, pasi eshte e ndaluar të përdoret sinjalizimi i përkohshëm dhe sinjalizimi i përhershëm ne te njejtën kohe.

Me përfundimin e punimeve në rrugë, sinjalet e përkohshme duhet te hiqen dhe duhet te vendosen sinjalet e përhershme.

Të gjitha sinjalet e përkohshëm duhet të jenë të lexueshme si ditën ashtu dhe natën.

Pengesa (barriera) normale dhe drejtim treguese

Pengesë normale në formë drejtkëndëshi e ngjyrosur me shirita të alternuar të kuq me të bardhë, me përmasa ku shiriti i kuq është sa 1.2 e shiritit të bardhë, në lartësi nga toka jo më tepër se 80cm. Pengesë drejtim treguese në formë drejtkëndëshi me përmasa jo më të vogla se 60x240 cm dhe jo më të mëdha se 90x360 cm.

Pengesat drejtim treguese mund të krijohen nga elementë të veçantë me përmasa 60x60cm deri 90x90cm, prej katër pjesësh që vendosen horizontalisht me bordin e poshtëm në një lartësi jo më pak se 80cm, të paraprirë dhe ndjekur nga sinjali “KALIM I DETYRUESHËM”.

Gjatë kryerjes së punimeve, kontraktori duhet të marr masa gjatë fazës së ndërtimit/rehabilitimit në mënyrë që të garantoj minimizimin e pengesave dhe ndërprerjeve të rrjedhjes së trafikut dhe sigurinë rrugore. Tabelat, dritat dhe pajisjet e sigurisë duhet të vendosen në mënyrë të sigurt, për të qënë të mbrojtura nga erërat ose trafiku lëvizës. Tabelat në kantier duhet të vendosen në largësi të mjaftueshme prej punimeve, në mënyrë që të bëjë paralajmërimin e duhur për trafikun në rrezik.




Fig 21. Pajisje për menaxhimin e trafikut

Vendosja e tabelave dhe elementëve që nevojiten për sigurinë në kantier;

Vendosja e tabelave rrugore dhe reflektorë për përvijimin e urës;

Në mënyrë që kalimi në urë të jetë sa më i sigurt dhe mos të paraqes rrezikshmëri për përdoruesit e saj, ura duhet të shoqërohet me disa tabela të cilat do të bëjnë të mundur dallimin nga ana e përdoruesit të rrugës për masat dhe kujdesin që duhet të ketë gjatë kalimit në të.

Vendosja e sinjalistikës vertikale tabelare lidhur me kufizimin e ngarkesave dhe dhënies së drejtës së përparësisë së kalimit;



Fig 22. Ngushtim simetrik në të dyja anët/majtas/djathtas



Fig 23. E drejtë përparësie, në drejtimet një kalimshe të alternuara

Duhet të behet ndriçimi i rrugës në hyrje dhe në dalje dhe i urës;

7 ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Nga ana e shoqërisë projektuese është dhënë mënyra e organizimit të punimeve të ndërtimit, e cila përfshin zonën ku do të ngrihet kantieri i ndërtimit.

Plan organizimi ka marrë parasysh:

1. Pozicionimin planimetrik të kantierit të ndërtimit.

Kjo ka të bëjë me faktin që kantieri është parashikuar të vendoset në mënyrë të tillë që të ketë rrugë të përshtatshme dhe nga mjete të ndihmës së shpejtë për raste të emergjencave, impakti ndaj ambjentit të jetë minimal, si dhe pozicioni i kantierit të jetë efikas dhe i shpejtë në çdo pikë të objektit

2. Minimizimi në maksimum të zhurmave dhe të ndotjes në të gjitha zonat ekzistuese në zonën e projektit
3. Minimizimi i ndërhyrjeve që bëhen në terren jashtë atyre të parashikuara në projekt.
4. Respektimi i kushteve teknike të zbatimit për ngritjen e kantierit

Kontraktori është përgjegjës për sigurinë në kantier dhe që kantieri i ngritur të jetë i pajisur me rrugë lidhëse me rrugën ekzistuese, të ketë energji elektrike 24orë/ditë, të ketë qendrën e ndihmës së shpejtë, të jenë të rrethuar, dhe të pajisur me tabelat informuese.





Në përfundim të punimeve sipërfaqja dhe zona përreth kantierit duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme.

PROJEKTUES

“HTS COMPANY” sh.p.k

Ing. Skender CELA

KONSTRUKSIONI I URES



Elemente qe do te zevendesohen me hekur ϕ 20

Detaj per tirantimin e shufrave te hekurit

OBJEKTI:	REHABILITIM URBAN NE TE DY ANET E RRUGES ARKITEKT KASEMI, BASHKIA SKRAPAR	TE DHENA MBI PROJEKTIN		GRUPI I PROJEKTIMIT "HTS COMPANY" SH.P.K				
		EMRI I FLETES:	KONSTRUKSIONI I URES	ARKITEKT	BESNIK SPAHIA			
POROSITESI:	BASHKIA SKRAPAR	FAZA:	PROJEKT-ZBATIM	ING.NDERTIMI	SKENDER CELA	ING. HIDROTEKNIK	KUJTIM BILAJ	
		SHKALLA:	1:100	ING.ELEKTRIK	RASIM MAJKO			
		NR.FLETES:	K-01	ING.MEKANIK	ALMA MITRE			
		VITI:	2023	ING.TOPOGRAF	LULZIM GUMA			